



RAPORT MONITORIMI MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË KËSHILLIT TË INVESTIMEVE Janar – Dhjetor 2019

RRETH RAPORTIT

Raporti i parë i këtij lloji përgatitur nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve, ka si qëllim dokumentimin & informimin e partnerëve të KI mbi impaktin e punës së KI.

Sekretariati i Këshillit të
Investimeve
Tiranë, Janar 2020

Përmbajtja

HYRJE	3
METODOLOGJIA	5
REKOMANDIME 2015-2019	5
STATUSI I REKOMANDIMEVE	7
SFIDA DHE KUFIZIME	10

HYRJE

Këshilli i Investimeve u krijua në vitin 2015 nga Qeveria e Shqipërisë me mbështetjen e BERZH-it në kuadrin e Iniciativës për përmirësimin e Klimës së Investimeve dhe Qeverisjes së mirë (ICGI). Kjo platformë luan një rol të rëndësishëm në debatin kombëtar mbi çështje prioritare të klimës së investimeve në vend.

Me qëllim përmirësimin e efikasitetit të punës së KI, raportimin e rezultateve si dhe për të forcuar rolin dhe impaktin e tij në raport me institucionet shtetërore dhe sektorin privat, Sekretariati i KI u fokusua në aktivitetet monitoruese mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve të KI gjatë vitit 2019. Ky raport synon të japë një përmbledhje të progresit të arritur, duke u përqendruar kryesisht në vitin 2019.

KI ka mbajtur 18 mbledhje (2015-2019) ku diskutimet midis anëtarëve janë bazuar në punën analitike, kërkimore dhe këshilluese të ndërmarra nga ekspertët e Sekretariatit. 154 rekomandime u adresuan nga Sekretariati ndërsa 34 rekomandime të tjera u referuan gjatë diskutimeve nga anëtarët e Këshillit. Kështu, në total që nga krijimi i tij, anëtarët e Këshillit të Investimeve kanë aprovuar 188 rekomandime për përmirësimin e klimës së investimeve, nga të cilat 37% aktualisht janë zbatuar.

Në vitin 2019, u morën masa konkrete nga institucione të ndryshme sa i përket zbatimit të rekomandimeve të KI-së. Aktualisht, 34 rekomandime janë marrë në konsideratë specifikisht në lidhje me:

- Reformimin e inspektimeve, kryesisht në drejtim të unifikimit të praktikave administrative mbi inspektimet në nivelin qendror dhe lokal. Për më tepër, janë ndërtuar listat e verifikimeve për të gjithë inspektoratet dhe u ndërmorrën trajnime të inspektorëve mbi procesin e inspektimit online.
- Reformën mbi Informalitetin, ku theksojmë miratimin e VKM-së që synon formalizimin në sektorin e turizmit përmes kategorizimit imperativ të strukturave turistike që veprojnë në këtë sektor. Për më tepër, Ministria e Financave dhe Ekonomisë prezantoi një aplikacion inovativ "Stop Informalitetit" të përdorur nga rreth 13,800 të regjistruar që ndikojnë në luftën kundër informalitetit.
- Publikimin e vizionit, misionit, objektivave dhe politikave në sektorin e turizmit përmes aprovimit të "Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Qendrueshëm të Turizmit 2019 - 2023". Kjo strategji shtron drejtimet drejt formalizimit dhe zhvillimit të këtij sektori.
- Ndryshimet ligjore që nxisin incentiva fiskale në drejtim të thjeshtimit të TVSH-së për operatorët e sektorit bujqësor. Skema e kompensimit të TVSH për prodhuesit bujqësorë u rishikua nga 20% në 6% për këtë kategori. Një ndryshim tjetër ka të bëjë me përjashtimin nga skema e TVSH-së që nga janari i vitit 2019, I

subjekteve që furnizojnë me inpute bujqësore, siç janë plehurat, pesticidet, farat, fidanët etj.

- Forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve publike, në lidhje me implementimin e rekomandimeve të KI, të ndjekura përmes tre grupeve të punës të krijuara ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE) dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.
- Reformën e Deregulimit, që pati progres pozitiv këtë vit, përmes thjeshtimit të procedurave nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me zbatimin e procedurës "Dogana pa Letra" që ndikon 93% të të gjithë subjekteve që operojnë me doganën. Për më tepër, evidentohet një rritje në numrin e e përdorimit të aplikimeve dhe vërtetimeve të lëshuara krejtësisht online nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave, tashmë 12 dokumente online me rreth 90,000 përdorues (janar-tetor 2019).
- Mbështetje për inovacion për rininë dhe kompanitë e reja (start-up) në sektorin e TIK përmes nxitjes së investimeve të reja në qendra të teknologjisë së informacionit (IT Hubs) si p.sh. "Tech Hub" ose Qendra e IT pranës Piramidës. Shumë e rëndësishme për t'u përmendur është stimulimi i investimeve dhe krijimi i vendeve të punës në sektorin e BPO-ve (nënkontraktimi i proceseve të biznesit) që prej vitit 2019. Për shembull, nga aktivitetet e Risi Albania në këtë sektor, janë krijuar mbi 600 vende pune.
- Ngritja e kapaciteteve të administratës tatimore dhe edukimi i tatimpaguesve mbi procedurat dhe kërkesat tatimore.

Në katër vite, Këshilli i Investimeve është konsoliduar si strukturë dhe format, ndërsa Sekretariati i KI ka përvetësuar një metodologji të strukturuar mbi "debatin publik privat" duke fokusuar punën e tij në:

- 1) Konsultime me komunitetin e biznesit, qeverinë dhe partnerët ndërkombëtarë për zhvillim, mbledhjen e propozimeve mbi axhendën për përmirësimin e klimës së investimeve në vend;
- 2) Analizë ligjore, anketime, konsultime, hulumtimi i raporteve kombëtare dhe ndërkombëtare, intervista me bizneset, mbledhja e komenteve me shkrim nga partnerët, organizimi i takimeve në nivel teknik, ngritjen e grupeve konkrete të punës mbi implementimin e rekomandimeve dhe ndërtimin e një baze të dhënash mbi çështjet e ngritura nga përfaqësuesit e biznesit;
- 3) Përgatitja e rekomandimeve dhe masave specifike për t'u implementuar nga institucionet përgjegjëse mbi zgjidhjen e problematikave të evidentuara nga fazat e mëparshme;
- 4) Monitorim i statusit të implementimit të rekomandimeve të KI.

Ky raport përqendrohet në pikat e mësipërme 3 dhe 4, duke synuar:

- një përditësim të statusit të rekomandimeve të miratuara në mbledhjet e Këshillit të Investimeve;
- progresin e bërë dhe impaktin e rekomandimeve të implementuara gjatë vitit 2019


METODOLOGJIA

Aktivitetet e mëposhtme monitoruese të ndërmarra gjatë vitit 2019, janë burimi i informacionit për përgatitjen e këtij raporti:

- Takime direkte me përfaqësues të institucioneve përgjegjëse për implementimin e rekomandimeve;
- Shkëmbim formal informacioni përmes shkresave zyrtare në vijim të mbledhjeve të KI ku adresohen rekomandimet për t'u implementuar si dhe shkresa mbi ndjekjen e progresit të implementimit;
- Ndjekje e ndryshimeve në kuadrin ligjor, vendime të Këshillit të Ministrave, vendime të ministrave, ndryshime ligjore, akte ligjore, strategji, politika, plane pune, të ndryshuara/miratuara gjatë 2019 me qëllim identifikimin e ndryshimeve që lidhen me përmbushjen e rekomandimeve;
- Monitorim ditor i mediave sociale e vizuale mbi artikuj që lidhen me përmbushjen e rekomandimeve;
- Takime me anëtarët aktualë dhe atyre të mëparshëm (2018), mbi opinionet dhe perceptimet mbi platformën e Këshillit të Investimeve, mbi çfarë mund të përmirësohet në të ardhmen dhe forma të tjera bashkëpunimi. Përgatitje e raportit me komentet e anëtarëve;
- Hulumtimi i raporteve ndërkombëtare si Doing Business, Competitiveness Reports, etj. për një vlerësim të impaktit të rekomandimeve të KI-së, që lidhet me indikatorët e përmirësuar nga këto raporte.
- Kërkim të dhënash dhe shkëmbim informacionesh me institucionet përgjegjëse për të matur efektin e rekomandimeve të Këshillit të Investimeve në komunitetin e biznesit.


REKOMANDIME 2015-2019

Që prej vitit 2015, Këshilli i Investimeve ka mbajtur 18 mbledhje ku janë adresuar tema specifike dhe janë dhënë rekomandime konkrete për përmirësimin e klimës së investimeve. Rekomandimet e miratuara nga anëtarët sipas temave të trajtuara paraqiten në grafikun vijues:




Rekomandimet e lëshuara nga KI janë të kategorizuara në katër shtylla kryesore: (i) Strategjike, (ii) Institucionale, (iii) Ligjore dhe (iv) Transparencë.


Ndërhyrjet e propozuara nën kategorinë Institucionale, si ndryshime/përmirësime strukturore, procedurale, politika, veprime dhe ngritje kapacitetesh, përbëjnë 46% të rekomandimeve. Rekomandimet në kategorinë Transparencë kanë një peshë të konsiderueshme me 9% të totalit të rekomandimeve.



Në terma të përgjithshme, bazuar në rekomandimet e lëshuara, **37% e tyre janë përmbushur dhe 19% janë në proces implementimi** përmes hapash konkrete por janë larg përmbushjes së plotë të tyre.




Këshilli i Investimeve ka miratuar rekomandime që synojnë ndërhyrje në sektorë të ndryshëm, por pesë sektorët më të rëndësishëm të adresuar jepen në grafikun e më poshtëm. Niveli i informalitetit dhe rekomandimet se si të luftohet, janë trajtuar në dy mbledhje në lidhje me sektorët e turizmit (në 10% të totalit të vlerësimit) dhe bujqësisë (në 9% të totalit), të dy sektorë potencialë për rritje të qëndrueshme dhe investimesh në Shqipëri. 8% e rekomandimeve kanë të bëjnë me sektorin BPO-ve, një temë shumë e diskutuar për potencialin e zhvillimit të punësimit të të rinjve.




STATUSI I REKOMANDIMEVE

Gjatë vitit 2019, ka patur progres në drejtim të përbushjes së rekomandimeve të KI përmes përbushjes së 34 rekomandimeve dhe 2 në proces. Në bazë kategorish, 50% e atyre që janë përbushur i referohen ndërhyrjeve të ndryshme Institucionale, e ndjekur me 26% ndryshime Ligjore, 18% rekomandime në nivel Strategjik dhe 6% rritje Transparence nga institucionet shtetërore.




Angazhim mbi përmbushjen e rekomandimeve, ka patur në drejtim të unifikimit të procesit të inspektimeve dhe thjeshtimit të tij përmes kalimit online duke rezultuar në 26% përmbushje nga rekomandimet e adresuara në mbledhjen “Mbi inspektimet”.


Mbi skemën e rimbursimit të TVSH-së, specifikisht për fermerët, janë bërë ndryshime në vijim të 12 rekomandimeve të KI-së, përkatësisht (18%) në dy mbledhje, “Mbi rimbursimin e TVSH-së” dhe “Informaliteti në Bujqësi”.



Ndërkohë, rekomandimet e papërbushura brenda afateve të dakorduara nga anëtarët, sipas temave paraqiten në tabelën më poshtë, ku është e dukshme që për temat e trajtuara në mbledhjet e vitit 2018 dhe 2019 si “Mbi potencialet e investimeve dhe sektorët prioritarë”, “Siguria juridike mbi pronën” dhe “Formalizimi i Turizmit”, ka një nivel realizimi të ulët që justifikohet me faktin që rekomandimet duan një kohë të konsiderueshme për t’u realizuar nga institucionet shtetërore.



Rekomandimet në proces, të cilat institucionet i kanë marrë parasysh për implementim dhe kanë filluar punën për realizimin e tyre, përmbledhen më poshtë sipas temave të trajtuara në KI.



Siç vihet re, numrin më të madh të rekomandimeve në proces, e ka tema mbi platformën e-lejet, ku Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT) ka marrë masa konkrete për realizimin e tyre brenda këtij viti.

Fushat kryesore të ndërhyrjes ku rekomandimet e implementuara stimuluan veprime konkrete nga institucionet përgjegjëse gjatë vitit 2019, janë:

- 1) Vazhdimësia dhe qëndrueshmëria e reformave mbi: Inspektimet, Informalitetin, Turizmin, Deregulimin;
- 2) Incentivat fiskale;
- 3) Ngritje kapacitetesh të burimeve njerëzore;
- 4) Përmirësim i bashkëpunimit ndër-institucional;
- 5) Rritje transparence;
- 6) Mbështetje për inovacion.

Në aneksin e mëposhtëm, do gjeni një përmbledhje të rekomandimeve më relevante të përmbushura, veprimet konkrete të ndërmarra nga qeveria e institucionet përgjegjëse për implementimin e tyre, si dhe një ndikim fillestar të tyre tek komuniteti i biznesit dhe në përmirësimin e klimës së investimeve.

SFIDA DHE KUFIZIME

Përmbushja e rekomandimeve të Këshillit të investimeve është një proces që kërkon angazhimin e vullnetin e shumë institucioneve dhe bazohet kryesisht në dokumentacion të evidentuar në rrugë formale. Nga aktivitetet monitoruese, kemi hasur disa kufizime:

- Procesi i mbledhjes së të dhënave, vështirësohet duke qënë se disa nga institucionet përgjegjëse nuk përgjigjen në kohë ose nuk angazhohen në kthimin e përgjigjeve në rrugë formale mbi rekomandimet që u janë adresuar;
- Mungesë të dhënash dhe në shumë raste mungesë totale vlerësimi ndikimi nga ana e institucioneve qeveritare mbi impaktin që strategjitë, politikat, incentivat apo planet e veprimeve kanë patur mbi bizneset. Kjo vështirëson edhe matjen e impaktit të rekomandimeve të KI adresuar qeverisë;
- Mungesë e një vlerësimi që në fillim të programit mbi monitorimin e indikatorëve përkatës;
- Rekomandimet që adresojnë ndryshime ligjore duan shumë kohë për t'u përmbushur, kjo ndikon në relevancën e këtyre rekomandimeve dhe impaktin e tyre kur ato përmbushen me vonë;
- Ndryshimet e implementuara nga institucionet qeveritare, në shumë raste nuk publikohen në rrugë zyrtare, ato thjesht promovohen përmes postimesh në rrjetet sociale e median e shkruar.

Fushat e ndërhyrjes	Rekomandime	Arritje Konkrete	Ndikim
A. Vazhdimësi & Qëndrueshmëri Reformash			
Inspektive	<p>Unifikim i praktikave administrative mbi Inspektimet në nivelin qendror dhe lokal, përmes krijimit të një inventari të të gjithë kuadrit ligjor dhe rregulloreve për tu ndjekur në procesin e inspektimeve; bërja e tij i aksesueshëm nga të gjithë përdoruesit.</p> <p>Përgatitja/përmirësimi dhe publikimi i metodologjive të përdorura nga inspektorët për vendosjen e masave administrative të përshtatshme dhe proporcionale.</p> <p>Publikimi i komentareve; finalizimi i listave të verifikimeve të funksionit të inspektoratit në inspektoratet e nivelit lokal;</p> <p>Kryerja e inspektimeve online në nivelin lokal</p>	<p>Listat e verifikimit, kërkesat ligjore të të gjitha ligjeve sektoriale janë përmbledhur në një pyetësor për të gjitha fushat e inspektimit dhe janë të arritshme online për të gjithë entitetet publike dhe private. Ato janë dizajnuar dhe zbatuar në sistemin e inspektimit online "E-Inspektimi", me qëllim verifikimin e përputhshmërisë ligjore në veprimtarinë e tyre private.</p> <p>Të gjithë inspektoratet shtetërore kanë publikuar në faqet e tyre zyrtare, bazën e ligjore dhe nënligjore. Publikimi i ligjeve dhe akteve nënligjore në faqen e internetit të Inspektoriatit Qendror është i arritshëm për të gjithë aktorët e përfshirë në një proces inspektimi në kohë reale.</p> <p>Inspektoriatit Qendror ka përgatitur një draft VKM i cili është dorëzuar për miratim në KM (ende nuk është aprovuar). Është hartuar "metodologjia e vlerësimit të bazuar në pikëzim" e cila po aplikohet dhe pilotohet nga disa prej inspektorateve për masat administrative sipas rëndësisë së shkeljes së gjetur.</p> <p>Listat e verifikimeve janë përpiluar dhe zbatuar për fushat e inspektimit në juridiksionin e inspektorateve lokale. Inspektorët e 6 qarqeve janë trajnuar ndërkohë.</p> <p>Hartimi i dokumenteve standarde në përputhje me ligjin për inspektimin ka sjellë unifikimin e procesit të inspektimit për të gjithë organet inspektuese qendrore dhe vendore. Rregullorja e miratuar "Për krijimin e procedurës së inspektimit si një proces i rregullt administrativ", ka rezultuar në unifikimin efektiv të këtij procesi tashmë të dixhitalizuar.</p>	<p>Përmes standardizimit të procedurave të inspektimit dhe zbatimit të tyre nga të gjithë inspektoratet, ndikohet në <u>uljen e nivelit të korrupsionit që perceptohet nga komuniteti i biznesit në këtë drejtim.</u></p>

<p>Turizëm</p>	<p>Përfundimi dhe miratimi i Strategjisë së Turizmit.</p>	<p>Miratimi përmes VKM 413 dt.19/06/2019 i "STRATEGJISË KOMBËTARE PËR ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM TË TURIZMIT 2019 - 2023". Kjo strategji përcakton vizionin, misionin, objektivat strategjike dhe politikat drejt zhvillimit të sektorit të Turizmit. Krijon terrenin e duhur për formalizimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm përmes planeve të veprimit.</p>	<p>Përfitues nga kjo strategji janë të gjitha bizneset që operojnë në sektorin e Turizmit, i cili zë rreth 15% të të gjithë sektorit të shërbimeve e 11% të gjithë veprimtarisë ekonomike në Shqipëri si dhe jep një kontribut të drejtpërdrejtë prej 8.5% të PBB-së, punëson rreth 7.7 % të fuqisë punëtore në Shqipëri dhe mbulon 7.5% të investimeve në vend.</p>
<p>Informaliteti</p>	<p>Qeveria e Shqipërisë të sigurojë stimuj që mund të shoqërojnë luftën kundër informalitetit.</p> <p>Përputhshmëri dhe respektim i kërkesave rregullatore e fiskale për të gjithë zinxhirin e subjekteve që veprojnë në sektorin e turizmit.</p>	<p>Këshilli i Ministrave miratoi Vendimin (VKM) nr 415 dt.19.06.2019 për formalizimin e strukturave turistike që veprojnë në këtë sektor duke bërë të domosdoshëm kategorizimin e tyre.</p> <p>Që nga Korriku 2019, Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave dhe inspektorate të ndryshme, filluan një plan veprimi operativ anti-informalitet dhe vunë në dispozicion të publikut aplikacionin online "Stop Informalitetit" për të mundësuar sinjalizimin mbi subjektet informale, duke synuar përfshirjen e komunitetit në uljen e informalitetit.</p>	<p>Përmes kësaj VKM impaktohen 20.180 biznese që operojnë në sektorin e turizmit në shërbimet e akomodimit duke përmirësuar konkurrencën dhe duke rritur formalizimin e tyre dhe të gjithë sektorit.</p> <p>Aktualisht, në aplikacionin Stop Informalitetit, ka rreth 13.800 përdorues të regjistruar që u ndërgjegjësuam mbi mundësinë e ndikimit në uljen e informalitetit.</p>

0

<p>Deregulim</p>	<p>Thjeshtime në procedurat doganore dhe tatimore. Aplikimet për autorizime ose vërtetime duhen bërë online dhe dokumentet e skanuara duhet të merren në konsideratë.</p> <p>Reduktimi i burokracive administrative me synim shërbimin më të shpëjtë dhe eficient në veçanti për bizneset e mesme, të vogla dhe mikro, si dhe vënien në dispozicion të shërbimeve të reja për taksapaguesit.</p>	<p>Në Maj të vitit 2019, u prezantua procedura online – “Dogana pa letra” që u heq bizneseve detyrimin e paraqitjes fizike në sportelet doganore për paraqitjen e deklaratave doganore, pasi aktualisht këto dokumenta mund të lëshohen të vulosura vetëm në mënyrë elektronike.</p> <p>Gjatë vitit 2019, numri i dokumenteve të lëshuar krejtësisht online nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave arriti në 12 vërtetime dhe deklarata.</p>	<p>“Dogana pa letra” ndikon drejtpërdrejt 93% të përdoruesve të procedurave doganore që tashmë kalojnë përmes procesit online. Aktualisht, vetëm 7% e të gjithë operatorëve doganorë që konsiderohen si subjekte me rrezik të lartë, kalojnë përmes një kontrolli fizik bazuar në dokumente. Për më tepër, kjo procedurë shkurton ndjeshëm kohën e pritjes së bizneseve në doganë, zvogëlon kostot e tyre dhe minimizon kontaktin midis biznesit dhe doganave, duke ulur indirekt korrupsionin. Ai gjithashtu përshtat ligjin dhe Kodin Doganor me legjislacionin e BE-së.</p> <p>Në periudhën Janar-Tetor 2019, përmes portalit e-Albania janë ofruar 82.772 shërbime online nga Administrata Tatimore. Shërbime këto që ofrohen në kohë reale, pa asnjë kosto.</p>
<p>B. Incentiva Fiskale</p>			
	<p>Thjeshtimi i skemës së kompensimit të TVSH-së për fermerët.</p> <p>Për të inkurajuar investimet në bujqësi dhe blegtori, rimbursimet e TVSH-së duhet të jenë të zbatueshme në të gjithë zinxhirin e vlerës, përfshirë ciklin e prodhimit (në varësi të nënsektorëve të veçantë).</p>	<p>Në shkurt 2019 Ministria e Financave dhe Ekonomisë, lëshoi Udhëzimin nr.3 dt.21.02.19 pëmes të cilit u bënë ndryshime mbi skemën e kompensimit të TVSH për prodhuesit bujqësorë. Shkalla e TVSH-së u ul nga 20% në 6% për këtë kategori biznesesh.</p> <p>Në VKM-në nr.12, datë 09.01.2019, subjektet që furnizojnë me inpute bujqësore, siç janë plehrat, pesticidet, farat, fidanët, etj. u përjashtuan nga TVSH-ja.</p>	<p>Këto ndryshime ligjore, <u>ndikojnë 40.953 biznese</u> që operojnë në këtë sektor dhe u japin atyre më shumë hapësirë për të ulur kostot e veprimtarisë bujqësore e për të rritur investimet në bujqësi si dhe mundësojnë që ndërmarrjet bujqësore të importit dhe tregtisë të ulin çmimet e shitjeve për fermerët me të njëjtën madhësi të TVSH-së.</p>

C. Ngritje kapacitetesh të Burimeve Njerëzore			
	<p>Qëndrueshmëria e aftësimi i stafit të inspektorateve dhe administratës tatimore është domosdoshmëri për t'iu përgjigjur kërkesave të biznesit për një administrim të shpejtë, efikas dhe pa ngarkesë burokratike.</p> <p>Edukim fiskal i tatimpaguesve përsa i përket taksave, procedurave të TVSH-së dhe ndryshimeve legjislative që ndikojnë në biznesin e tyre.</p>	<p>Gjatë vitit 2019, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave organizoi trajnime për specialistët e tyre, inspektorët dhe gjithashtu për taksapaguesit. I gjithë personeli i agjencive shtetërore që u ofron shërbime në sportel qytetarëve ishte subjekt i një trajnimi të përqendruar në ASPA për "Kodin e Etikës" dhe "Kartën e Qytetarëve".</p> <p>Personeli i administratës tatimore dhe inspektorët e kontrollit nga Zyra e Taksave të Tatimpaguesve të Mëdhenj, Drejtoria Rajonale e Taksave në Tiranë dhe Drejtoria e Përgjithshme, u njohën me praktikatat më të mira ndërkombëtare në auditim dhe kontabilitet në një trajnim të organizuar nga DPT në bashkëpunim me AARC Dublin, Irlandë (Kompani konsulence në Kontabilitet dhe Auditim). Gjithashtu, drejtuesit e lartë të administratës tatimore janë trajnuar për të rritur aftësitë e tyre drejtuese në një trajnim të organizuar në bashkëpunim me USAID.</p> <p>Për më tepër, Inspektorati i Përgjithshëm ka trajnuar të gjithë inspektorët e inspektorateve shtetërore në Republikën e Shqipërisë, dhe gjithashtu ka filluar trajnimin e inspektorëve lokalë me trajnimin e tyre në gjashtë qarqe. Në zbatim të Ligjit për inspektimin, është bërë një draft VKM për vlerësimin dhe testimin e inspektorëve (në përshtatje dhe me Kodin e Punës).</p>	<p>Qëndrueshmëria e aftësimi i stafit të inspektorateve dhe administratës tatimore është domosdoshmëri për t'iu përgjigjur kërkesave të biznesit për një administrim të shpejtë, efikas dhe pa ngarkesë burokratike.</p> <p>Edukim fiskal i tatimpaguesve përsa i përket taksave, procedurave të TVSH-së dhe ndryshimeve legjislative që ndikojnë në biznesin e tyre.</p>
D. Bashkëpunim ndër-institucional			
	<p>Konsolidimi i koordinimit ndër-institucional dhe bashkëpunimi i të gjithë inspektorateve është me rëndësi thelbësore për</p>	<p>Në vitin 2019 për të inkurajuar Inspektoratet Shtetërore të zbatojnë legjislacionin në fuqi në fushën e inspektimit, Inspektorati i Përgjithshëm ka koordinuar inspektimet e përbashkëta në disa fusha të inspektimit.</p>	<p>Bashkëpunimi në kryerjen e inspektimeve të përbashkëta ka një efekt pozitiv në <u>uljen e barrës administrative</u> mbi biznesin dhe merr një rëndësi të veçantë edhe në kuadër të <u>uljes së informalitetit</u> ku roli i funksioneve të</p>

	<p>suksesin e reformës së inspektimeve.</p> <p>Krijimi i tre grupeve punuese të nivelit teknik për të ndërmarrë veprime konkrete drejt zbatimit të rekomandimeve të Këshillit të Investimeve, për tre fusha prioritare me potencial për rritje, me përfaqësues të secilës ministri përkatëse (përfshirë MFE).</p>	<p>Në një kohë shumë të shkurtër (2 muaj), nën udhëheqjen e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë, u përgatitën dhe nënshkruan (Dhjetor 2019) tre vendime të përbashkëta me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisi për krijimin e tre grupeve të punës të përbërë nga përfaqësues të ministrive përkatëse, përfshirë akademinë dhe përfaqësues të biznesit gjithashtu.</p>	<p>inspektimit ka ndikim në funksionimin e tregut.</p>
<p>E. Rritje Transparence</p>			
	<p>Më shumë transparencë nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave, veçanërisht promovimi i mundësisë që bizneset të aplikojnë për Informacionin tarifor të Detyrueshëm në faqen e internetit të DPD dhe të publikojnë të gjitha vendimet e marra për këto kërkesa si dhe të rristet transparenca e treguesve kryesorë të rrezikut të përdorur nga sistemi elektronik i rrezikut për të identifikuar bizneset me rrezik të lartë.</p>	<p>Aktualisht Informacioni tarifor i Detyrueshëm është i publikuar në faqen e internetit të DPT. Për më tepër, më 25.11.2019, GDT publikoi në faqen e saj të internetit 18 kriteret që mund të përbëjnë rrezik potencial (kryesisht për TVSH dhe tatimin mbi fitimet), në raportimin "de juro" të transaksioneve dhe aktivitetin "de fakto" që po ndodh.</p>	<p>Përmes qartësisë në procedurat, kërkesat dhe vendimet e publikuara, 162.835 biznese përfitojnë duke i aksesuar këto informacione lehtësisht.</p> <p>Publikimi i kriterëve të riskut u jep mundësinë të gjithë tatimpaguesve që të kontrollojnë vetë situatën e tyre bazuar në këto kriterë dhe të parashikojnë nëse ata do t'i nënshtrohen kontrollit, kështu që i edukon ata të veprojnë sipas rregullave dhe të parandalojnë gjokat e mundshme.</p>

F. Mbështetje për Inovacionin

	<p>Mbështetje për iniciativat e biznesit për krijimin e qendrave të trajnimit të vazhdueshëm në teknologji dhe inovacion (Akademi ICT), si dhe “softëare house” me qëllim shtimin e ekspertëve të certifikuar në ICT.</p> <p>Nxitja e trajnimeve përmes kontratave që ndërmarrjet e IT mund të marrin nga shteti (përfshirja e studentëve ose të diplomuarve për praktikë në profesione përkatëse).</p>	<p>Në vitin 2019 u dha mbështetje e konsiderueshme në drejtim të nxitjes së trajnimeve, praktikës profesionale, ideve të bizneseve fillestare. P.sh. nën koordinimin e Agjensisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) është ngritur “Tech Space” një IT Hub që i jep mundësi të rinjve të bëhen pjesë dhe të zhvillohen përmes saj.</p> <p>Për më tepër, Bashkia e Tiranës në bashkëpunim me Fondin Shqiptaro-Amerikan të Zhvillimit, kanë iniciuar kthimin e godinës së “Piramidës” në një qendër të TIK-ut.</p>	<p>Përmes këtyre iniciativave stimuluese, mund të zgjidhet pjesërisht problemi i mungesës së aftësive të kualifikuara të punës në sektorin e TIK.</p> <p>Mjaft i rëndësishëm është edhe stimulimi i investimeve dhe krijimi i vendeve të punës në sektorin BPO. Që prej vitit 2019, ndërhyrja nga Risi Albania ka kontribuar në krijimin e mbi 600 vendeve të reja punës.</p>
--	---	--	---

Asnjë pjesë e këtyre faqeve, qoftë tekst apo imazh nuk mund të përdoret për ndonjë qëllim tjetër përveç atij të përcaktuar. Këshilli i Investimeve është një platformë e ngritur nga autoritetet shqiptare me mbështetjen e BERZH-it për të rritur dialogun midis qeverisë dhe sektorit privat, për të përmirësuar klimën e biznesit dhe për të nxitur qeverisjen e mirë. Puna e Këshillit mbështetet nga Sekretariati, një organ i pavarur me profesionistë të përzgjedhur dhe kontraktuar nga BERZH për t'u angazhuar drejtpërsëdrejti me komunitetin e biznesit. Financimi aktual për Sekretariatit ofrohet nga Sekretariati Shtetëror Zvicerian për Çështje Ekonomike (SECO)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË



European Bank
for Reconstruction and Development



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

State Secretariat for Economic Affairs SECO

Këshilli i Investimeve mbështetet nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Sekretariati Shtetëror Zvicerian për Çështje Ekonomike (SECO)